



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN281120210002

Tiranë, më: 06.12.2021

Komisioni 55

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri:

VENDOSI :

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person Juridik: “Vlora International Airport - VIA” sh.p.k

Nr. NIPT-i: M11809002I

Adresa e selisë: Rr. “Donika Kastrioti”, Ndërtesa 4, kodi postar 1119, Nj.B. Nr.5, 1000, Tiranë.

Personi përgjegjës: Valon Lluka

Për të zhvilluar projektin “**Ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, Shtojca I, Pika 7. b) Ndërtimi i aeroporteve me pista që kanë një gjatësi bazë prej 2 100 m ose më tepër. Në kuptim të këtij ligji “aeroport” nënkupton aeroporte, të cilat përputhen me përkufizimin e dhënë në Konventën e Çikagos më 1944, që themeloi Organizatën Ndërkombëtare Civile të Aviacionit (Shtojca 14 e kësaj konvente).

Vendndodhja: Zona Kadastrale:1007, Nr. Pasurisë:6, Akërni, Njësia Administrative Novoselë, Vlorë.

Sipërfaqja: 309 ha

Kapaciteti: 1.01 deri në 2.04 milion pasagjerë në vit

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen ngazhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;
Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

- Në rëndësinë strategjike që ka projekti për sa i përket zhvillimit të infrastrukturës dhe turizmit
- Në Vendimin Nr. 813, datë: 16.12.2019 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së Administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të Pronës Nr. 914, me emërtimin “Aerodrom Fushor”, me vendodhje në Vlorë dhe për një ndryshim në Vendimin Nr. 515, datë: 18.07.2003 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.
Pika 1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të Pronës Nr. 914, me emërtimin “Aerodrom Fushor”, me vendodhje në Vlorë, sipas planvendosjes bashkalidhur Vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij, për t’a përdorur për infrastrukturë aeroportuale, për ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA).
- Vendimi nr. 10, datë 28.12.2020 i KKT-së “Për miratimin e kufijve të zonave të mbrojtura”, ka shfuqizuar këtë zonë si Zonë e Mbrojtur.

2. Mendimi i institucioneve të konsultuara:

Drejtoritë teknike të Ministrisë shprehin mendimin si më poshtë:

- Të kontrollohen periodikisht kushtet teknike të mjeteve të punës për të shmangur dhe parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, çlirimin e ndotësve të gaztë, të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve;
- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga automjetet rrugore, të përcaktuara sipas legjislacionit kombëtar në fuqi për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis;
- Të monitorohet vazhdimisht cilësia e ajrit gjatë fazës së punimeve dhe shfrytëzimit, me qëllim mbajtjen e shkarkimeve në ajër brenda normave të lejuara dhe brenda zonës së projektit;
- Të përgatitet dhe të zbatohet rigorozikisht plani i monitorimit dhe menaxhimit të mjedisit;
- Lënda djegëse që do të përdoret nga mjetet e punës, të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit specifik për cilësinë e lëndëve djegëse;
- Të parandalohen aksidentet që shkaktojnë ndotje te ajrit ose mjedisit, Kur në mënyrë aksidentale ndodh derdhja e karburantit apo vajit, materiali i derdhur të mblidhet, të pastrohet vendi përkatës, dhe materialet e grumbullura të depozitohen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurtë;
- Të spërkatet rregullisht me ujë sipërfaqja e shfrytëzimit dhe rrugëve të transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit dhe ngritjes së tij. Forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë;
- Të kontrollohet vazhdimisht dhe të funksionojë rregullisht, sistemi i aspirimit dhe ventilimit të gazeve dhe pluhurave nga operationet nëntokë me qëllim eliminimin e efekteve negative në jeten e minatoreve të çlirime të gazeve;
- Të merren masa për menaxhimin dhe shmangien e trafikut që do krijohet për shkak të makinerive dhe automjeteve të punës, menaxhimin në kohë të tij;

- Gjatë transportit të mjeteve dhe materialeve të punës, automjetet mos të ngarkohen më shumë se kapaciteti i projektuar dhe të mbulohen me mbulesa, për të parandaluar rrjedhjet në rrugë dhe emetimin e pluhurave.
- Të sigurohen struktura për larjen dhe pastrimin për automjetet/rrotat e automjeteve, para daljes nga vendi i aktivitetit.
- Sugjerojmë që gjatë zhvillimit të aktivitetit të zbatohet legjislacioni në fuqi në fushën e zhurmave.
- Sugjerojmë që mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të aktivitetit të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve.
- Miratimi i ndryshimit të sipërfaqes së zonës së mbrojtur mjedisore, zgjerimi ose pakësimi i saj bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit ku argumentohet nevoja e ndryshimit konkret që do të përmirësojë rrjetin dhe mbrojtjen e zonës pas vendimit të KKT-së për ndryshimin e sipërfaqes së zonës së mbrojtur mjedisore.
- Vendimi nr. 10, datë 28.12.2020 i KKT-së “Për miratimin e kufijve të zonave të mbrojtura”, ka shfuqizuar këtë zonë si zonë e mbrojtur.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:

- **Faza e Ndërtimit:**

1. Të shfrytëzohet sistemi ekzistues i rrugëve duke shmangur në maksimum hapjen e gjurmve të reja, si në fazën e ndërtimit dhe të funksionimit.
2. Të shmangen punimet që janë në një gjatësi jo më pak se 600 m nga Kriporja në periudhën nga mesi i muajit majit deri në korrik, për të mos shqetësuar shpendët gjatë periudhës së shumimit të tyre në këto zona.
3. Referuar Masave zbutëse dhe menaxhuese – peizazhi dhe komoditeti vizual firma ndërtuese në bashkëpunim me ekspertët e fushës të përcaktojë specifikisht ngjyrat që nuk ndikojnë në peizazhin dhe impaktojnë sa më pak mjedisin, veçanërisht për avifaunën, dhe kjo të jetë e detyrueshme gjatë gjithë periudhës së funksionimit të aeroportit.
Bimët e prezantuara në kuadër të planit të rehabilitimit të peizazhit të jenë lloje autoktone të përshtatura me peizazhin e zonës, duke shmangur “thyerjen” e peizazhit.
4. Gjatë fazës së punimeve të shmanget plotësisht puna gjatë natës, veçanërisht në distancë deri në 600 m nga kriporia, si dhe ndriçimi i panevojshëm i kantierit. Të përcaktohet domosdoshmërisht përdorimi i pajisjeve LED me kënd të ulët, të prerë në projektimin dhe zbatimin e punimeve të infrastrukturës së aeroportit.
5. Siç përcaktohet edhe në raportin e VNM-së, zona e gjurmës së aeroportit është zonë e rëndësishme për folenizimin e shpendëve të tokës. Të realizohet një “Pre Construction Survey” dhe të merren masa për deprivimin e shpendëve për realizimin e folenizimit, në periudhën Mars-Prill.
Masa të propozuara lidhen me vendosjen e elementëve që trembin shpendët në zonat e identifikuara, si shirita vezullues, tullumbace dhe cdo mase tjetër që të sigurohet mosinstalimin e tyre në zonën ku do të zhvillohen punimet.
6. Të mos lejohet shkarkimi i ujërave të ndotura në trupat ujorë natyrorë të zonës.
7. Përcaktimi dhe informimi për kufijëve e qartë të shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve në kantier dhe në territorin e zonës së mbrojtur për të zvogëluar mundësinë e ndikimit të drejtpërdrejtë (aksidentet) me faunën e egër.
8. Nevojitet të merret në konsideratë përkujdesja për rindërtimin e nënkalimeve dhe komunikimeve të shkëputura të habitateve për të zgjidhur problemin e migrimit të kafshëve.
Për këtë në bashkëpunim me specialistët e fushës të përcaktohen vendet për ndërtimi i kalimeve (urave) nëntokësore për mos fragmentimin e habitatit.

• **Faza e Funkcionimit:**

1. Kompania të hartojë dhe zbatojë Planin e Menaxhimit Ekologjik për gjatë gjithë periudhës së funksionimit të aeroportit, i rishikueshëm në afat 5 vjeçar, në bashkëpunim me stafin e zonës së mbrojtur dhe të sigurojë menaxhimin dhe qëndrueshmerine për specie më të rrezikuara që ndodhen në zonë (Pelikani kaçurrel, Pulbaradha këmbëverdhë, Kaloresi, Sqepbiza, Gjelaci symadh, Dallëndyshja ballëbardhë e detit, Dallëndyshja e zakonshme e detit, Vrapuesi gushëbardhë, Shqipja e baltinave, Flamingo, Laroshja Shqipja e kënetës) si edhe specie të tjera të përcaktuara në planin e menaxhimit ekologjik. Kompania duhet të angazhohet në menaxhimin dhe financimin e aksioneve të konservimit të tyre, si dhe cdo element tjetër i përcaktuar në raportin e VNM-së. Në plan të përfshijë detyrimisht komponent te monitorimit shkencor. Planet e menaxhimit të specieve të kërcënuara të jenë pjesë integrale në planin e menaxhimit ekologjik. Plani duhet hartuar para vendosjes në funksionim të aeroportit dhe pjesa kyçe duhet të jenë objektivat e rehabilitimit/kompesimit të financuara nga subjekti. Suporti për programe edukimi, restaurim habitatesh dhe rigjenerimin të popullatave të kafshëve të egra.
2. Kompania të ketë parasysh shmangien e fluturimeve ose devijimin e trajektores së uljes dhe ngritjes së avionëve gjatë periudhave të migrimit të shpendëve, veçanërisht në periudhën e shtegëtimit të shpendëve që i përkon me periudhën e muajit Marsit kryesisht (shtegtimi i pranverës) dhe nga Gushti në Tetor (shtegtimi i vjeshtës). Përcaktimi i saktë i koridorëve dhe publikimi i linjave të fluturimit do të ndihmonte në këtë drejtim, për të lejuar specialistët e lëvizjes së avionëve gjatë periudhave të migrimit të verifikojnë respektimin e masave të përcaktuara. Plani të përfshihet edhe në planin e menaxhimit ekologjik.
3. Ujërat e ndotura të prodhuara gjatë operimit të aeroportit të trajtohen në impiante përpunimi.
4. Përsa i përket ndikimit të ndriçimit të aeroportit, të sanksionohet përdorimi i domosdoshëm i pajisjeve LED me kënd të ulët, të prerë në projektimin e infrastrukturës së aeroportit. Të specifikohen dhe të argumentohen rastet kur përdorimi i këtyre pajisjeve të ndriçimit nuk është i mundur. Në këto raste të kërkohet miratim nga institucionet përgjegjëse.
5. Raportet e monitorimit të gjëndjes së mjedisit duhet të bëhen pjesë e planit të menaxhimit ekologjik dhe të raportohen rregullisht.
6. Të hartohet dhe publikohet paraprakisht Plani i Menaxhimit kundër zjarreve dhe permbytjeve dhe identifikimi i rrezikut të përplasjes me shpendët dhe masat e rekomanduara në raste perplasjes të shpendeve.
7. Aeroporti të percaktojë nje individ ose strukturë të veçantë përgjegjës për të monitoruar dhe raportuar mbi komponentet mjedisor, që do të mbajë kontaktet me AKM/AKZM-në.
8. Të zgjidhet një konsulent i jashtëm mjedisor për biodiversitetin, që duhet të jetë një subjekt i pavarur, me njohuri të thelluara në aspektet mjedisore të përcaktuara në VNM. Në Komitetin e Menaxhimit të zonave të mbrojtura në qarkun Vlorë, do të përfshihen administratori i aeroportit dhe konsulenti mjedisor, të cilët do të kenë detyrimtë raportojnë mbi realizimin e planit te menaxhimit ekologjik.
9. Me qëllim zbutjen e ndikimit, të shmangët plotësisht shfrytëzimi i tokave bujqësore përreth gjurmës së aeroportit. Kompania mund të blejë ose të marrë në përdorim tokat bujqësore që rrethojnë aeroportin dhe të sigurohet që të mos realizohen ndërhyrje si masë zbutëse për kompesimin e dëmtimit të habitateve.
10. Të minimizohet zbatimi i masave zbutëse për të cilat nuk është i qartë impakti i tyre mjedisor si:
 - Përdorimin e zhurmuesve stacionerë dhe të lëvizshëm për të larguar shpendët në afërsi të pistës së aeroportit.
 - Përdorimin e predatorve (siç janë skifterët/fajkonjtë) të stërvitur për largimin e shpendëve nga pista.
 - Sigurimi i patrullimit periodik për rreth pistës të pajisur me eksplozive/fishekë zhurmues.

Kjo kërkon vlerësimin e ndikimit të këtyre masave të propozuara dhe efikasitetin e tyre në raport me dëmin që mund të sjellin.

11. Të përcaktohen kufijtë të qartë dhe specifike të shpejtesise së lëvizjes së automjeteve brënda zonës së mbrojtur, te cilet duhet të jenë pjesë e planeve të rrepta të monitorimit.

Agjencia Rajonale e Mjedisit: Shprehet parimisht dakort për zhvillimin e aktivitetit, duke sugjeruar kushte në funksion të mbrojtjes së mjedisit.

Bashkia Vlorë shprehet: pozitivisht për zhvillimin e aktivitetit

• **Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komunitetet e zonave, përfaqësues nga Pushtetet Vendore si dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 3.1 Ky vendim është I vlefshëm, nëse ndërtimi I objektit është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 3.2 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kopetente.
- 3.3 Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të ketë marrë miratim nga institucionet kopetente.
- 3.4 Subjekti duhet të tregoj kujdes të veçantë për menaxhimin e mbetjeve inerte duke mos I hedhur ato në mjedise ujore.
- 3.5 Të kryhen punimeve në gjurmët e projektit të propozuar.
- 3.6 Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gërmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
- 3.7 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.8 Për asnjë arsye mos të ketë prerje pemësh në zonën ku do të zhvillohet projekti.
- 3.9 Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët.
- 3.10 Të bëhet rrethimi i zones ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
- 3.11 Gjatë fazes së rikonstruksionit të mbahet nën kontroll ndotja e ajrit, Brenda standarteve të OBSH-së;
- 3.12 Subjekti të kujdeset përmenaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për rmenaxhimin e mbetjeve inerte"
- 3.13 Për asnjë arsye mos të ketë hedhje të mbetjeve inerte pranë burimeve ujore.
- 3.14 Vendosja e ndriçimit gjatë rrugës të bëhet në bashkëpunim me organet kopetente të energjisë elektrike.

- 3.15** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negative në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 3.16** Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.17** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.18** Në raste aksidentesh ose defektesh që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 3.19** Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 3.20** Para funksionimit të aktivitetit, subjekti duhet të marrë masa lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të zeza duke instaluar sistemin e trajtimit ose kanalizimin e tyre me rrjetin kryesorë të zonës.
- 3.21** Për sa i përket parandalimit dhe zvogëlimit të pasojave në mjedis dhe rehabilitimit të mëvonshëm të tij, sugjerojmë:
- Vendosjen e shenjave paralajmëruese rrugore dhe përgatitjen e udhëzime për drejtuesit e automjeteve, me qëllim uljen e numrit të vrasjeve aksidentale të kafshëve;
 - Sigurimin e të gjitha paisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në rast emergjencash;
 - Kur është e mundur, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin, veçanërisht për gjitarët dhe shpendët;
 - Me rëndësi të veçantë është rehabilitimi i peizazhit në të gjithë gjurmën e projektit;
 - Të minimizohet dëmtimi i sipërfaqëve të panevojshme gjatë ndërtimit;
- 3.22** Gjatë zbatimit të projektit, kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet e vendosura në Deklaratë, në zbatim të:
- Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
 - Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”;
 - Çdo veprim i kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit, çon në kundravjetje administrative dhe bëhet objekt i zbatimit të Ligjit Nr 10433, datë: 16.06.2011 “PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” dhe Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar.

3.23 Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

Të kryhet monitorimi i masave të deklaruar në raportin e VNM dhe të bëhet gjurmimi i përputhshmërisë se tyre me masat konkrete në zbatimin e projektit. Vlerësimi i efektivitetit të masave të dokumentohet në raporte periodike 6 mujore dhe të raportohet në AKM.

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”

- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojnë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	08.06.2022	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	08.06.2022	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	08.06.2022	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	08.06.2022	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ 40 µg/m ³	08.06.2022	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodicite ti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	08.06.2022	Çdo 6 muaj

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Deklarata Mjedisore për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprahe, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Konfirmoi:

Aneksi 1. Planvendosja e sipërfaqes së objektit dhe koordinatat.



Vendndodhja e zonave urbane

<https://geoportal.asig.gov.al>
Data e Printimit: 02.09.2021.

445140.330
4501066.414

457484.148
4501066.414



445140.330
4493214.375

457484.148
4493214.375

<https://geoportal.asig.gov.al>: ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH

Numri i pikës	Gauss Kruger	
	Veri	Lindje
50	4499622.13	4365498.53
54	4499629.86	4365753.11
61	4497293.55	4368725.08
64	4496690.32	4368439.94
71	4497544.42	4367073.25
75	4499099.41	4365127.03